

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Grupi Aricoma a.s. Republika Çeke, do të fitoj kontrollin mbi
Sabris s.r.o., Sllovaki
(lënda nr. 08-32/2023)**

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 09.02.2023, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Grupi Aricoma a.s. me seli në Vinohradská 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke, në kontroll të plotë të Grupit KKCG, synon të fitoj kontrollin e plotë mbi Sabris s.r.o. me seli në Prievozská 4B, Jinonice, 821 09 Bratislava, Sllovaki.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Grupi Aricoma a.s. është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë bijë të saja - veçanërisht **Autocont AEC a.s.** dhe **Sabris Consulting s.r.o.** Autocont fokusohet në zbatimin e projekteve të ndërmarrjeve të mëdha dhe klientëve të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturë TI, aplikacione të korporatave, mbështetje për proceset e biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e TI-së. **AEC a.s.** ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë. **Sabris Consulting s.r.o.** është aktive në zbatimin e SAP dhe shërbimet e mirëmbajtjes SAP. Grupi Aricoma a.s i përket Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikë, patundshmëri, industri dhe teknologji të zgjuara dhe është aktive në 33 vende të botës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e terminaleve të video lotarisë dhe teknologjisë informatike përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAKEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - lojërat e fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - lojërat e fatit dhe basteve;
- Seavus SHPKNJ Shkup, me aktivitet parësore - programim kompjuterik; dhe
- Qendra për edukim dhe zhvillim Seavus SHPKNJ Shkup, me aktivitet parësor - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër.

Sipas parashtruesit të njoftimit, treg relevant për vlerësimin e përqendrimit është tregu i shërbimeve të teknologjisë informatike ("IT") në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email:

kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.02. 2023

Shkup